

# ÇFARË MUND TË BËNI NËSE KENI QENË VIKTIMË E NJË KRIMI / INCIDENTI TË URREJTJES?

Në rast Urgjence gjithmonë  
telefononi 999/112

- Raportoni Krimin e Urrejtjes në Stacionin tuaj Policor lokal. Lista e plotë e Stacioneve Policore është në dispozicion në [www.garda.ie](http://www.garda.ie)
- Kontaktoni Linjën Konfidenciale të Policisë në:  
**1800 666 111**
- Përdorni Shërbimin Policor të Raportimit të Krimin të Urrejtjes në Internet në [www.garda.ie](http://www.garda.ie)
- Vizitoni [www.garda.ie](http://www.garda.ie) për më shumë informacione mbi:
- Krimet / Incidentet e Urrejtjes
- Gjeni Zyrtarin tuaj Policor lokal të Diversitetit në [www.garda.ie](http://www.garda.ie)

**#LETSSTOPHATETOGETHER**

Një pjesë e financuar nga  
(Policia) e Fondit të Sigurisë së  
Brendshme të BE-së



An Garda Síochána  
Mbjajta e Njerëzve të Sigurt

## KRIMI I URREJTJES ËSHTË I PAPRANUESHËM



<b>VENDOSNI MË POSHTË DETAJET E STACIONIT TUAJ LOKAL</b>
EMRI I STACIONIT: _____
NR I TELEFONIT: _____
NUMRI I TELEFONIT TË MBIQYRJES NË KOMUNITET: _____
<b>ZYRTARI POLICOR I DIVERSITETIT</b>
EMRI: _____
NR I TELEFONIT: _____
<b>INSPEKTORI</b>
EMRI: _____
NR I TELEFONIT: _____

Njësia Kombëtare e Policisë mbi Diversitetin  
dhe Integrimin

[diversity@garda.ie](mailto:diversity@garda.ie)

01-6663150



Raportoni Krimin e  
Urrejtjes Tani

# ÇFARË ËSHTË KRIMI I URREJTJES?

Krimi i Urrejtjes është i ndryshëm nga llojet e tjera të krimit sepse kryhet kundër jush për shkak të asaj që jeni. Është një sulm personal ndaj diçkaje në lidhje me ju që ju nuk mund ta ndryshoni ose nuk duhet ta ndryshoni, të tilla si ngjyra juaj, raca, feja, gjinia, orientimi seksual, etj.

Veprat përfshijnë Sulmet, Dëmet Penale, Kundërvajtjet e Ngacmimit dhe Rendit Publik. Ju duhet ta raportoni Krimin e Urrejtjes tek An Garda Síochána.

## DEFINICIONET

An Garda Síochána ka përkufizime për Krimin e Urrejtjes dhe gjithashtu për Incidentet e Urrejtjes Jo-Kriminale (këtu e tutje referuar si 'Incidentet e Urrejtjes'.)

### *Krimi i urrejtjes:*

Çdo vepër penale që perceptohet nga viktima ose ndonjë person tjetër që, tërësisht ose pjesërisht, të motivohet nga armiqësia ose paragjykimi, bazuar në moshën aktuale ose të perceptuar, paaftësinë, racën, ngjyrën, kombësinë, etninë, fenë, orientimin seksual ose gjininë.

### *Incidenti i urrejtjes:*

Çdo incident urrejtjeje që perceptohet nga ndonjë person që, tërësisht ose pjesërisht, të motivohet nga armiqësia ose paragjykimi, bazuar në moshën aktuale ose të perceptuar, paaftësinë, racën, ngjyrën, kombësinë, etninë, fenë, orientimin seksual ose gjininë.

Këto janë incidente që nuk mund të përbëjnë një vepër penale, por sidoqoftë janë të dëmshme dhe shqetësuese. Shembujt përfshijnë Abuzimin Verbal, Bullizmin, Materialin Ofendues ose Gjestet dhe Abuzimin në internet. Ju duhet t'i raportoni këto tek An Garda Síochána.



## KUSH MUND TË JETË VIKTIMË E URREJTJES?

Një person, komunitet ose institucion mund të jetë viktima e Urrejtjes. Nëse keni përjetuar një akt dhune, frikësimi ose armiqësie për shkak të asaj që jeni, mund të keni qenë viktima e një Krimi të Urrejtjes.

Nëse nuk jeni të sigurt nëse ajo që ju ka ndodhur është një Krim / Incident i urrejtjes, raportojeni atë dhe ne do të ndërmarrim veprimet e nevojshme.

## KU MUND TË NDODHIN KRIMET/ INCIDENTET E URREJTJES?

Krimet/ Incidentet e urrejtjes mund të ndodhin kudo: në rrugë, në një dyqan apo bar, në punë, në shkollë, në internet ose në shtëpi.

# ÇFARË DO TË BËJË AN GARDA SÍOCHÁNA?

An Garda Síochána i merr shumë seriozisht Krimet / Incidentet e Urrejtjes. Ne do të japim një përgjigje të shpejtë dhe të plotë për të gjitha raportet që marrim.

### *Krimi i Urrejtjes:*

Do të hetojmë të gjitha raportet e Krimin të Urrejtjes me ndjeshmëri dhe respekt.

### *Incidenti i Urrejtjes:*

Do të regjistrojmë të gjitha Incidentet e Urrejtjes dhe do të marrim masa, sipas rastit, në rrethana.



Strategjia aktuale e Policisë mbi Diversitetin dhe Integrimin është në dispozicion për t'u shkarkuar në 14 gjuhë në [www.garda.ie](http://www.garda.ie)